



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Iir Ferati, Kryetar i Komunës së Istogut Enver Rugova, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Istogut	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Venera Çerkini, Zv. Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 13.07.2022 Nr. 020-608
Zyrtarët përgjegjës:		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Sanije Dërguti, Zyrtare e lartë për Monitorimin e Komunave	
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë e aktit të Kuvendit të Komunës së Istogut	
Lloji i aktit:	Vendimi 00Nr.97/2022 për zgjedhjen e zëvendës kryesuesit të Kuvendit të komunës për komunitete	

I/e nderuar Kryetar,
I/e nderuar Kryesues,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në mbështetje të nenin 81.4 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK)nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, MAPL, me datë: 07.07.2022, ka pranuar për vlerësim Vendimin 00Nr.97/2022 për zgjedhjen e zëvendës kryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete, të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Istogut.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, kërkon:

Rishqyrtimin e Ligjshmërisë së Aktit

Vendimin 00Nr.97/2022 për zgjedhjen e zëvendës kryesuesit të Kuvendit të komunës për komunitete.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Istogut në mbledhjen e mbajtur me datë 29.06.2022, ka miratuar Vendimin 00Nr.97/2022 për zgjedhjen e zëvendës kryesuesit të Kuvendit të komunës për komunitete.

MAPL, konstaton se vendimi 00Nr.97/2022 nuk është në përputhje me nenin 54 paragrafi 54.1 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ku sqarohet se: Në komunat ku së paku 10% e qytetarëve i takojnë komuniteteve jo shumicë, posti i Zëvendës kryesuesit të Kuvendit të Komunës për komunitete rezervohet për përfaqësuesin e këtyre komuniteteve. MAPL, pasi ka verifikuar të dhënat e regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 si dhe vlerësimeve të regjistrimit të popullsisë për vitin 2012, ka konstatuar se në komunën e Istogut nuk jetojnë së paku 10% të qytetarëve që u takojnë komuniteteve jo shumicë andaj edhe kuvendi i komunës nuk mund të emërojë Zëvendës kryesues të kuvendit të komunës për komunitete.

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, konstaton se vendimi si i tillë nuk krijon efekt juridik dhe kërkon nga Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës së Istogut që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbete në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za:	Iir Ferati, gradonačelnik opštine Istok Enver Rugova, predsedavajući Skupštine opštine Istok	
Kopija:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-a Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Elbert Krasniqi, ministar MALS-a Venera Çerkini, zamenica generalnog sekretara MALS-a	
Od:	Besim Myrtezani, zamenik rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština / MALS	Datum: 13.07.2022 br. 020-608
Odgovorni službenici:	Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština Sanije Dërguti, viša službenica za monitorisanje opština	
1. Službenik-ca za utvrđivanje pravne procene:		
2. Službenik-ca za izradu pravne procene:		
Predmet:	Zahtev ponovno razmatranje zakonitosti akta Skupštine opštine Istok	
Vrsta akta:	Odluka 00 br.97/2022 o izboru zamenika predsedavajućeg Skupštine opštine za zajednice	

Poštovani gradonačelniče,
Poštovani predsedavajući,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa članom 81.4 Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, Uredbom Vlade br. 02/2021 o oblastima i administrativnim odgovornostima Kancelarije premijera i ministarstava, kao i Uredbom br. 06/2021 o izmenidopuni Uredbe (VRK) br. 10/2019, o administrativnom razmatranju opštinskih akata, MALS je dana, 7.7.2022.godine, primilo radi procene zakonitosti Odluku 00 br. 97/2022 o izboru zamenika predsedavajućeg Skupštine opštine za zajednice, usvojenu od strane Skupštine opštine Istok.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave (MALS) nakon razmatranja zakonitosti navedenog akta, zahteva:

Reviziju Zakonitosti Akta

Odluka 00 br. 97/2022 o izboru zamenika predsedavajućeg Skupštine opštine za zajednice.

Obrazloženje

Skupština opštine Istok na sednici održanoj dana, 29.6.2022.godine, usvojila je Odluku 00 br. 97/2022 o izboru zamenika predsedavajućeg Skupštine opštine za zajednice.

MALS, konstatuje da Odluka 00 br. 97/2022 nije u skladu sa članom 54 stav 54.1 Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi koji pojašnjava da: U opštinama u kojima najmanje 10% građana pripada nevećinskim zajednicama, mesto zamenika predsedavajućeg Skupštine opštine za zajednice rezervisano je za predstavnika ovih zajednica. MALS je, nakon provere podataka popisa stanovništva iz 2011. godine kao i procene popisa stanovništva za 2012. godinu, zaključio da u opštini Istok ne živi najmanje 10% građana koji pripadaju nevećinskim zajednicama, stoga skupština opštine ne može imenovati zamenika predsedavajućeg skupštine opštine za zajednice.

Na osnovu gore navedenog, Ministarstvo administracije lokalne samouprave konstatuje da odluka kao takva ne stvara pravno dejstvo i zahteva od Skupštine opštine i gradonačelnika opštine Istok, preduzimanje konkretnih mera kako bi akt opštine uskladile za zakonskim odredbama na snazi u vremenskom roku od 30 dana, od dana prijema zahteva za reviziju akta opštine.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za bilo kakva dalja pojašnjenja u vezi sa ovom procenom.